



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada- Government

Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice
Kabineti i Ministres së Drejtësisë- Ured Ministra Pravde- Cabinet of Minister of Justice

Nr. 338 / 2025
Datë: 23 / 07 / 2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, në përputhje me nenin 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 5 dhe 35 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-294 për Zyrtarët Publik, si dhe në pajtim me shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-Nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Zëvendësministri në detyrë i Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Agron Thaqi, Drejtor i Departamentit për Laborator Mjeko-Ligjor në Institutin e Mjekësisë Ligjore caktohet ushtrues detyre i Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Mjekësisë Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë.
2. Ushtruesi i detyrës sipas pikës (1) të këtij vendimi obligohet që detyrat dhe përgjegjësit e tij, t'i kryej në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Periudha e ushtrimit të detyrës sipas pikës (1) të këtij vendimi fillon nga data 23/07/2025 dhe zgjatë sipas legjislacionit përkatës në fuqi për zyrtarët publikë.
4. Shfuqizohet Vendimi me Nr. 338/2022 të datës 09.12.2022.
5. Obligohet Instituti i Mjekësisë Ligjore për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Pozita e Drejtorit të Përgjithshëm në Institutin e Mjekësisë Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë ka kaluar nëpër një procedurë rekrutimi, e cila ka përfunduar pa sukses dhe aktualisht mbetet pozitë e lirë.

Duke marrë parasysh natyrën specifike të funksionimit të Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe nevojën për angazhim të plotë të burimeve të planifikuara, është e domosdoshme që kjo Agjenci në Ministrinë e Drejtësisë të veprojë me kapacitete të plota dhe të sigurohet vazhdimësia e punës.

Andaj, duke u bazuar në të lartëcekurat dhe në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Blerim SALLAHU

Zëvendësministër në detyrë i Drejtësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Z. Agron Thaqi;
- Kabinetit të Ministres në detyrë të Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares të Përgjithshme;
- Institutit të Mjekësisë Ligjore;
- Arkivit të MD-së.